

**I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 3 (tre) vende të lira për personel akademik me kohë të plotë pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës në Departamentin e Arkitekturës si më poshtë:**

1. Lektor në lëndët “Studio Arkitekture 5, 6”, në Programin e studimit MSHA - Profili Arkitekt.
2. Asistent - lektor në lëndët “Workshop 1, 2, 3”, në Programin e studimit Bachelor në Arkitekturë Interieri e Dizajn.
3. Asistent - lektor në lëndët “Gjeometri Deskriptive dhe Vizatim Teknik”, në Programin e studimit MSHA (Profili Arkitekt, Profili Urbanist), si dhe në programe Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, Hidro, Mjedisi e Gjeodezi.

**A. Kushtet, kriteret e vlerësimit dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë kandidatët për pozicionin Lektor në lëndët “Studio Arkitekture 5, 6”, në Programin e studimit MSHA-Profil Arkitekt, janë si vijon:**

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati**

- a. Të ketë Diplome të ciklit të dytë në Arkitekturë.
- b. Të ketë gradën shkencore Doktor.
- c. Kandidati për personel akademik me kohë të plotë duhet të ketë një mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta të të dy cikleve apo të ciklit të integruar, jo më pak se 80/100 (statuti i UPT-së, neni 42 pika b).
- d. Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë profesionale dhe akademike.
- e. Të zotërojë të paktën një nga gjuhët: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht.

**Liste e dokumentacionit që duhet të dorëzojë kandidati:**

1. Letër motivimi/interesi ku të përfshijë:
  - a. *Pozicionin e kërkuar*
  - b. *Arsyet e kandidimit*
  - c. *Çfarë i ofron kandidati institucionit / departamentit / grup-lëndëve*
  - d. *Përmbledhje mbi qasjen teorike / metodologjike të kandidatit për lëndët ku do të angazhohet. (500 fjalë)*
2. CV e plotë, akademike dhe profesionale.
3. Kopje të noterizuar të gradës shkencore, si dhe një përmbledhje të tezës së kryer. Gradat e fituara jashtë vendit, duhet të shoqërohen me dokumentin e njohjes nga MAS.
4. Kopje e noterizuar e diplomës së studimeve të larta si dhe e listës së notave. Diplomat e fituara jashtë vendit, duhet të shoqërohen me dokumentin e njohjes nga MAS.
5. Dokumentacion që provon njohjen e gjuhës së huaj.
6. Letër reference nga 2 persona me gradë ose titull akademik (referenca të paraqitet në zarf të mbyllur të firmosur nga referenti).
7. Fotokopje e pasaportës ose e kartës së identitetit.
8. *Portfolio* punësh të lidhura me disiplinat e vendit vakant.
9. Letër reference nga punëdhënësi i fundit.

Nëse ka, kandidati mund të paraqesë edhe:

10. Deri në dy publikime të plota të përzgjedhura (artikull, ese, punime shkencore etj.)
11. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar.
12. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore.
13. Vërtetim të gjendjes shëndetësore.

**B. Kushtet, kriteret e vlerësimit dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë kandidatët për 2 (dy) pozicionet Asistent-lektor në lëndët “Workshop 1, 2, 3”, në Programin e studimit Bachelor në Arkitekturë Interieri e Dizajn dhe Asistent-lektor në lëndët “Gjeometri Deskriptive dhe Vizatim Teknik”, në Programin e studimit MSHA (Profili Arkitekt, Profili Urbanist), si dhe në programe Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, Hidro, Mjedisi e Gjeodezi janë si vijon:**

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati**

- a. Të ketë Diplome të ciklit të dytë në Arkitekturë ose Dizajn.
- b. Kandidati për personel akademik me kohë të plotë duhet të ketë një mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta të të dy cikleve apo të ciklit të integruar, jo më pak se 80/100 (statuti i UPT-së, neni 42 pika b).
- c. Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë profesionale dhe akademike.
- d. Të zotërojë të paktën një nga gjuhët: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht.

**Liste e dokumentacionit që duhet të dorëzojë kandidati:**

1. Letër motivimi/interesi ku të përfshijë:
  - a. *Pozicionin e kërkuar*
  - b. *Arsyet e kandidimit*
  - c. *Çfarë i ofron kandidati institucionit / departamentit / grup-lëndëve*
  - d. *Përmbledhje mbi qasjen teorike / metodologjike të kandidatit për lëndët ku do të angazhohet. (500 fjalë)*
2. CV e plotë, akademike dhe profesionale
3. Kopje e noterizuar e diplomës së studimeve të larta si dhe e listës së notave. Diplomat e fituara jashtë vendit, duhet të shoqërohen me dokumentin e njohjes nga MAS.
4. Dokumentacion që provon njohjen e gjuhës së huaj.

5. Letër reference nga 2 persona me gradë ose titull akademik (referenca të paraqitet në zarf të mbyllur të firmosur nga referenti).
6. Fotokopje e pasaportës ose e kartës së identitetit.
7. *Portfolio* punësh të lidhura me disiplinat e vendit vakant.
8. Letër reference nga punëdhënësi i fundit.

Nëse ka, kandidati mund të paraqesë edhe:

9. Kopje të noterizuar të gradës shkencore, si dhe një përmbledhje të tezës së kryer. Gradat e fituara jashtë vendit, duhet të shoqërohen me dokumentin e njohjes nga MAS.
10. Deri në dy publikime të plota të përzgjedhura (artikull, ese, punime shkencore etj.)
11. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar.
12. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore.
13. Vërtetim të gjendjes shëndetësore.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **21.02.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.